

FJALA E DEPUTETES BLERINA GJYLAMETI

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sinqerisht, teksa dëgjojmë në këtë sallë dhe jo vetëm, por edhe në sallat e komisioneve, nuk kuptohet çoroditja totale që kanë disa kolegë të opozitës dhe më pak kuptohet se çfarë duan të thonë. Kemi pasur diskutime shumë të mëdha në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave se si duhet të ndërhyjmë, si qeveri, për të vijuar mbështetjen e kontratave publike, që janë parakusht për zhvillimin e disa sektorëve kyç të ekonomisë, sikundër ai i turizmit, i bujqësisë, i energjisë, por jo vetëm. Akti normativ që kemi sjellë bën të mundur vijimin e këtyre kontratave publike.

Ekonomia nuk mund të zhvillohet nëse nuk sigurojmë të gjitha parakushtet e infrastrukturës dhe jo vetëm, por ndërkohë dëgjojmë një çoroditje totale: pse e keni sjellë aktin normativ? Pse e keni për 300 kompani? Pse nuk e keni për 200 kompani? Pse nuk e keni për 10? Pse e keni bërë për 50? Unë e kuptoj që ka një çoroditje totale, sepse nuk e dini realisht se si duhet t'u drejtoheni atyre që ju kanë votuar. Ne sollëm këtu paketat e para pikërisht në mbështetje të familjeve që kanë më pak mundësi ekonomike, por jo vetëm; në mbështetje të atyre që janë edhe shtylla kryesore e ekonomisë shqiptare, që janë bizneset e vogla, por jo vetëm; mbështetëm familjet që nuk kanë mundësi për të ulur efektin e rritjes së çmimeve apo për kompensimin e shportës dhe sërish dëgjuam nga ju të njëjtat diskutime.

Ndajeni mendjen për kë jeni këtu, ndajeni mendjen çfarë doni të diskutoni dhe boll treguat çoroditje totale! Jua kuptojmë hallin, jua qajmë, por nuk jua zgjidhim dot. Besoj se sot duhet të kishim diskutuar së bashku nëse janë këto kontrata dhe ky kompensim. A shërben kjo për të vijuar rritjen ekonomike, e cila më pas të përktëhet jo vetëm në investime, por edhe në më shumë të ardhura për qytetarët shqiptarë? A po funksionon mirë qeveria me të gjitha paketat e

ndërhyrjes në ekonomi për të vijuar rritjen ekonomike dhe për të ulur efektet negative të kësaj krize botërore, apo jo? Cila është alternativa? Çfarë duhet të bëhet më mirë? Pse ne nuk ngrihemi një herë në nivelin e një debati konstruktiv në komisione?

Pse nuk vijmë edhe në seancë në nivelin e një debati konstruktiv, për të marrë disa vendime në funksion të qytetarëve? Në këto situata të vështira, në situata të jashtëzakonshme, ajo që duhet t'i bëjë bashkë ata që njerëzit kanë zgjedhur për t'i përfaqësuar, duhet të jetë interesi i atyre që na kanë votuar, jo interesi politik. Nuk bëhet politikë në kohë krize. Të bëhemi këtu bashkë për të diskutuar se çfarë duhet të bëjmë, çfarë pakete duhet të ndërmarrim. A mjafton ndërhyrja e qeverisë për të gjitha familjet në nevojë? A mjafton ndërhyrja që është bërë për bizneset e vogla? A mjaftojnë ndërhyrjet që janë bërë në një tjetër sektor kyç për ekonominë shqiptare, siç është bujqësia?

A duhet të vijojmë më tej me lehtësira fiskale për biznesin e vogël, por jo vetëm, por edhe për të gjithë ata që kanë më pak të ardhura? Këto duhet të jenë diskutimet tona. Duhet të kemi diskutime se çfarë duhet të bëjmë nëse kriza vazhdon për të gjitha materiet e para; ne jemi një vend që importojmë dhe çmimet do të rriten, sepse nuk janë në dorën tone. Kolegë të opozitës, Disa prej jush janë njerëz me të cilët unë diskutoj me kënaqësi të veçantë dhe jua dëgjoj shumë mendimin, por ka edhe kolegë tuajit që nuk kuptojnë asgjë nga ekonomia dhe marrin përsipër këtu, në këtë foltore, ta keqpërdorin për të folur për teori ekonomike që ende nuk janë shpikur.

Nuk mund të ulen të gjitha taksat dhe për të gjitha kategoritë, të kemi rritje të investimeve dhe mbështetje për të gjithë qytetarët që kanë më pak mundësi ekonomike. Nuk ekziston kjo teori. Diku do të dalin taksat. Duhet të ndani mendjen edhe për diçka. Është e vërtetë që shteti mbledh taksa dhe më pas në një mënyrë mendon se cilat janë politikat e duhura për të vijuar rritjen ekonomike. Ju keni qenë në qeveri. Pse nuk keni bërë paketa sociale për njerëzit në nevojë? Ju keni qenë në qeveri. Pse nuk keni pasur paketa të ndërhyrjes në ata sektorë të ekonomisë që prodhojnë rritje ekonomike? Ju keni qenë në qeveri. Pse nuk keni zgjidhur problematikat e njerëzve që ju kanë votuar? Ndërkohë, kemi 9 vjet që ju dëgjojmë vetëm të anatemoni çdo lloj politike që ndërmerr kjo qeveri.

E keqja është se këtë e bëni në emër të atyre që ju kanë votuar dhe ata gjithmonë e më pak ju votojnë e ju gjithmonë ngrini zërin në emër të tyre, ndërkohë që kuptohet, hallin nuk e keni për ta, por e keni për veten tuaj. Hallin e keni, sepse besoni që ende mund të vijoni me një politikë të vjetër të shpifjes, anatemimit, përbaltjes. Kjo mund të ndodhë në kohë reale, por ne jemi të ndryshëm, mendojmë ndryshe; në situata të jashtëzakonshme duhet të jemi bashkë. Në emër të tyre, duhet të diskutojmë alternativat bashkë. Në emër të tyre duhet të diskutojmë se si duhet të ndërhyjmë më shumë në mbështetje, por kjo nuk është e mundur nëse ekonomia nuk rritet, ndaj politikat e qeverisë ndër vite kanë treguar se janë të duhurat.

Rritja ekonomike vazhdon, inflacioni nuk është në normat që mendohej, edhe të pritshme, edhe duke u krahasuar me rajonin, por jo vetëm, por edhe duke u krahasuar me Europën. Kemi një rritje ekonomike që krahasimisht me rajonin është më e larta. Pra, ekonomia shqiptare po performon, por, të nderuar kolegë, është edhe sensitivitet. Mjaft me thirrje negative gjithë kohën! Boll me pjesën e të qarit dhe të ulëriturit për gjëmat që po ndodhin! Boll tentuat t'i futni frikën gjithkujt në këtë vend! Ejani të bëhemi bashkë dhe t'i zgjidhim problematikat që kemi, e kemi diskutuar disa herë këtë. Unë besoj se akti normativ është një tjetër hap, një tjetër ndërhyrje, që efektet do t'i shikojmë disa muaj më pas, do t'i shikojmë në 3- mujorin e fundit të këtij viti, do t'i shikojmë në 3-mujorin e parë të vitit tjetër, sikundër i pamë në ndërhyrjet që bëjnë gjatë pandemisë, që u reflektuan te rritja ekonomike dhe na dhanë mundësinë të kishim paketa të tjera në mbështetje të familjeve në nevojë, por edhe të biznesit.

Ejani të diskutojmë bashkë se si duhet punuar për të mbështetur jo vetëm kompanitë, që janë të angazhuara në infrastrukturë, sepse është parakusht. Pra, nuk mund të zhvillohet ekonomia, nuk mund të zhvillohet turizmi nëse nuk kemi infrastrukturë; nuk mund të zhvillohet bujqësia nëse nuk kemi mbështetje, nuk mund të zhvillohet i gjithë sektori i shërbimeve në Shqipëri, ku ekonomia jonë mbështetet nëse nuk ka investime. Pa dashur të zgjatëm shumë dhe pa dashur të diskutojmë të njëjtat çështje, të cilat na kanë ndarë dhe jo bashkuar, unë them se po ta shikojmë me vëmendje aktin normativ, nuk është rasti për ta votuar kundër, por është rasti për të kuptuar që në situata të jashtëzakonshme njerëzit duhet të ngrihen në nivelin e detyrës, që i është caktuar nga ata që i kanë votuar, e të marrin vendime të jashtëzakonshme. Faleminderit!